

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“SOL ENERGY 4” sh.p.k

Tiranë më datë 14/06/2022

NENI 1

Shoqëria Tregtare “SOL ENERGY 4” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “SOL ENERGY 4” sh.p.k

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive në fushën e energjisë elektrike

Konkretisht:

1. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike;
2. Ndërtimi, operimi dhe vënia në punë e parqeve fotovoltaike;
3. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshe, impiantet fotovoltaike, etj pa u kufizuar;
4. Ndërtimi, operimi dhe vënia në punë e hidrocentraleve;
5. Prodhimi i gazit; shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve;
6. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet;
7. Ndërtimi i parqeve fotovoltaike dhe prodhimi i energjisë nga burimet e rinovueshme;
8. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve;
9. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme;
10. Importi dhe sekporti i mallrave dhe pajisjeve të teknologjisë bnë fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e hidrocentraleve;
11. Mirëmbajtja e centraleve energjetike, etj.

Shoqëria mund të ushtrojë çdo lloj aktiviteti tregtar që legjislacioni i Republikës së Shqipërisë nuk e ndalon.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Barrikadave; Qendra Turdiu; K2; N17; Tiranë; Shqipëri**

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën **10.000.000 (dhjetë milion) lekë**.

Kapitali ndahet në 4 (katër) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. **Z. Arben Paja**, lindur më 15/03/1971, në **Zhapokike**, Shqipëri i Shtetësisë Shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Kartës së Identitetit nr. personal H10315299Q, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **30 %** të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë 3.000.000 (tre milion) Lekë;
2. **Z. Petrit Paja**, lindur më 20/03/1975, në **Zhapokike**, Shqipëri i Shtetësisë Shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Kartës së Identitetit nr. personal H50320164R, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **30 %** të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë 3.000.000 (tre milion) Lekë;
3. **Z. Theofilos Alimema**, lindur më 16/08/1972, në **Tepelene**, Shqipëri i Shtetësisë Shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Kartës së Identitetit nr. personal H20816095J, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **30 %** të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë 3.000.000 (tre milion) Lekë;
4. **Z. Zaho Kuka**, lindur më 05/05/1959, në **Nivice**, Shqipëri i Shtetësisë Shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Kartës së Identitetit nr. personal F90505279R, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **10 %** të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë 1.000.000 (një milion) Lekë

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është nënshkruar nga Ortakët Themelues.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është **Z. Arben Paja**, lindur më 15/03/1971, në **Zhapokike**, Shqipëri, shtetas Shqiptar, identifikuar nëpërmjet ID me nr. personal H10315299Q, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduajnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.


NENI 13

Dispozitat përfundimtare


Akt Themelimi hartohet në 4 (kater) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT


Z. Arben Paja



Z. Petrit Paja



Z. Theofilos Alimema



Z. Zaho Kuka

